



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 113, dt. 01.06.2015

Në mbështetje të nenit 17, pika 3, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, bazuar dhe në rregulloren “Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licensavetë ushtrimit të profesionit të restauratorit”, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 01.06.2015, pasi shqyrtoi kërkesën për pajisje me licensë në fushën e restaurimit, për shoqërinë e ndërtimit “Building Construction” sh.p.k., me drejtues teknik restaurator ark. Luçjano Bojaxhi, R.P. 51.,

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë së ndërtimit “Building Construction” sh.p.k me drejtues ligjor z. Aris Goxha, për pajisje me licensë në fushën e restaurimit për kategorinë C, “ Punime restaurimi në monumentet e arkitekturës për shoqëri ndërtimi në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës”.
 2. T’i propozojë Ministrit të Kulturës, pajisjen me licensë në fushën e restaurimit për kategorinë C, “ Punime restaurimi në monumentet e arkitekturës për shoqëri ndërtimi në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës” të shoqërisë së ndërtimit “Building Construction” sh.p.k me drejtues teknik restaurator ark. Luçjano Bojaxhi.
 3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
 4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI